

**QËNDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT**  
**STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“BRAINACTIONE” SHPK**

Në këtë Statut

- "Ligji" është ligji nr. 9901, dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare"
- "Statuti" është Statuti i Shoqërisë

**KAPITULLI I**

**Organizimi, emri, objekti, kohëzgjatja dhe selia ligjore**

**Neni 1**

**Data e themelimit, emri dhe themeluesit**

1. Sot, (data e firmosjes së statutit), ne themeluesit, krijuam një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin **BRAINACTIONE Sh.p.k**
2. Themeluesit e Shoqërisë janë (mbiemri, emri ose forma dhe emri ligjor i Shoqërisë, adresa ose selitë ligjore dhe vendi i regjistrimit)
  - **HUHET Sh.p.k.** themeluar më 04.11.2015 në bazë të Ligjit të Republikës së Shqipërisë me NIPT L52304014T (në cilësinë e përfaqësuesit ligjor PELLICANI Vito), Tiranë (Shqipëri),
  - **PELLICANI Massimo**, Bari (Itali), Rruga San Nicola n. 39/D me pashaportë ID AA2021147
  - **D’ALESSIO Maria**, Capurso (Itali), Via San Carlo, n.3 me Kartë Identiteti AS 1579170
  - **CARNIMEO Zeno**, Bari (Itali), Via Zanardelli, n.62 me pashaportë AA3962709

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin si më poshtë vijon:

Shoqëria ka për objekt kryesisht aktivitetin në sektorin e komunikimit, dhe në veçanti të:

- komunikim dixhital;
- hedhje të dhënash (data entry), përpunim dhe grumbullim të tyre (nënkupton manipulimin e thjeshte, te tyre, kompjuterike) për llogari të privatit, kompanive private dhe enteve shtetërore;
- furnizim dhe sisteme dematerializimi, teknologji informacioni (information technology), arkivim dokumentacioni;
- projektim dhe zhvillim i programeve të menaxhimit, sistemeve të kontrollit të menaxhimit si në formë të integruar ashtu edhe në shërbime të veçanta duke përfshirë emrin e domain dhe bazën e të dhënave;
- projektim, realizim dhe shpërndarje të imazheve dhe përmbajtjeve grafike, fotografike, televizive, radiofonike, dhe multimediali dhe nëpërmjet instalimit të fiksuar ose të lëvizshëm të strukturave publicitare dhe të pajisjeve promocionale;
- procedura të menaxhimit dhe të kontrollit të aparaturave të telekomunikimit, projektimit, realizimit dhe integritit sistematik të aparaturave eksperimentale për studime kërkimore publike dhe private;
- prodhim, mirëmbajtje dhe zhvillim i sistemeve të integruara, programeve dhe shërbimeve të menaxhimit të faqeve të internetit dhe instrumenteve të nevojshme për tregtimin elektronik dhe gjithçka tjetër të nevojshme për menaxhim, planifikim dhe organizim me mjete informatike të aktivitetit prodhues,

sherbimit telematik, ndertimit, instalimit, menaxhimit, përdorimit dhe mirëmbajtjes të rrjeteve telematike dhe të përmbajtjeve të tyre;

- organizim dhe realizim edhe për llogari të të tretëve, TV, gazeta, podcasting, rrjete sociale, printim letre, shfaqje, postera, mailing për panairë, udhëtime, eskursione, mbledhje, evente kulturore, reklama, konferenca, ekspozita, shfaqje teatrale dhe muzikore, aktivitete në përgjithësi, duke përfshirë veprat editoriale dhe multimediale si autovizive, CD-rom dhe në format DVD, revista, udhëzues, libra, broshura, me qëllim didaktik, reklamues dhe edukativ si dhe aktivitet reklamues të takimeve, debateve në rrethe të ngushta, në vende mbledhjesh, biblioteka, qendra kulturore dhe gjithçka tjetër që është e nevojshme për reklamimin dhe shpërndarjen e fushatave të komunikimit dhe/ose të informimit;
- aktivitet i marëdhënies dhe komunikimeve publike, aktivitet të pritjes, organizim i konferencave, duke përfshirë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave edhe me anë të makinerive elektronike;
- realizim dhe menaxhim i kurseve të formimit dhe të kualifikimit teknik-profesional, për privatët, ndërmarrjet dhe entet publike dhe private, kërkime të stazheve nëpër kompani me qëllim formimin profesional të të rinjve, në sektorët e listuar më lart, me aktivitet didaktik për institutet dhe entet trajnuese, asistencë në fushën e organizimit, menaxhimit dhe realizimit të projekteve të formimit profesional, prodhimit dhe tregtimit të sistemeve didaktike me qëllim mesimin në distancë, përfshirë edhe sistemet multimediale dhe audiovizive të komunikimit;
- aktivitet trajnues të teknikëve dhe konsulentëve në sektorin e informatikës dhe teknologjisë të telekomunikimit dhe të komunikimit;
- Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha aktivitetet e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, juridike, ekonomike, tregtare dhe industriale që janë të dobishme, të nevojshme ose të mundshme për arritjen e objektivit social, dhe veçanërisht ndër të tjera:
- marrin pjesë në ndërmarrje, entë ose Shoqëri, qofshin të themeluara ose për tu themeluar; krijim partneriteti me ente publike dhe private për të realizuar projekte me qëllim prezantimin dhe reklamimin e zhvillimit teknologjik;
- marrin kredi hipotekore, dhe të çfarëdolloji financimi tjetër në banka dhe strukturat e tjera që ushtrojnë aktivitet financimi, dhe japin garancitë e mundshme edhe në favor të të tretëve;
- mund të marrin mandatin e agjencisë dhe/ose përfaqësinë me ose pa depozitë, me ose pa ekskluzivitet.

### **Neni 3**

#### **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj për një periudhë të përcaktuar deri më 31/12/2035 duke filluar nga data e regjistrimit pranë Regjistrimit të Ndërmarrjeve dhe mund të zgjidhet me vendim të Ortakëve.

### **Neni 4**

#### **Selia Ligjore**

Selia ligjore e Shoqërisë është në adresën Tiranë (Shqipëri), Rruga Bogdanëve, Nr 15

## **KAPITULLI II**

### **KAPITALI**

#### **Neni 5**

#### **Kapitali bazë**

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100 Lekë në Lekun shqiptar c.a. ALL (njëqind Lekë) dhe përbëhet nga (4) kuota me vlerë nominale në Lekun shqiptar. Kapitali i Shoqërisë është i nënshkruar dhe tërësisht i derdhur në dorë, respektivisht nga Ortakët e Shoqërisë.

Pjesëmarrja e themeluesve të kapitalit të Shoqërisë është konform kontributeve të tyre si vijon:

1. HUHET Sh.p.k. jep në monedhën lekë 40,00 (dyzet/00), e barabarte me 1 kuote e barabarte me 40% te kapitalit
2. PELLICANI Massimo lindur më 10.10.1967 me pashaportë AA2021147 jep në monedhën lekë 20,00 (njëzet/00), e barabarte me nje kuote e barabarte me 20 % te kapitalit.
3. D'ALESSIO Maria lindur me 07.06.1982 në Bari, me Kartë Identiteti AS 1579170 jep në monedhën lekë 20,00 (njëzet/00), e barabarte me nje kuote e barabarte me 20 % te kapitalit.
4. CARNIMEO Zeno lindur më 12.04.1958 në Bari me pashaportë AA3962709 jep në monedhën lekë 20,00 (njëzet/00), e barabarte me nje kuote e barabarte me 20 % te kapitalit

5.

#### 6. Neni 6

##### Rritja dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i Shoqërisë mund të rritet nëpërmjet nënshkrimit të palëve të kapitalit bazë për kontributin në cash dhe për kontributin në natyrë nëpërmjet punësimit, nga ana e gjykatës kompetente, të një eksperti të licencuar për këtë lloj kontributesh sipas kërkesave të administratorit. Maxhoranca nuk mund të detyrojë, në asnjë rast, një partner të rrisë kontributin e tij bazë të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit është pranuar nga Asambleja e Përgjithshme, e cila do të vendosë sipas të njejtave kushte që ka për modifikimin e Statutit.

Gjithësesi, zvogëlimi i kapitalit i intereson partnerëve të bëhet në të njëjtën masë respektive që i takon në kapital.

#### Neni 7

##### Transferimi i Aksioneve

Aksionet dhe të drejtat do të blihet ose transferohen me anë të:

- Pjesëmarrjes në kapitalin Social të autorizuar në aktin e themelimit të Shoqërisë;
- blerje;
- trashëgimi;
- dhurimi;
- mënyra të tjera të parashikuara në ligj.

Pjesët takuese të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet partnerëve, përveç kur parashikohet ndryshe nga statuti.

Pjesët takuese të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme përmes trashëgimisë

### KAPITULLI III

#### ORGANI VENDIMMARRËS DHE DREJTORIA

#### Neni 8

##### Organi Vendimmarrës

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës i Shoqërisë.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit sipas modaliteteve që parashikon Ligji.

Asambleja e Pergjithshme merr vendimë për këto çështje të shoqërisë si vijojnë:

- a) përcaktim i politikave të shoqërisë;
- b) ndryshim statuti;
- c) zgjedhje dhe pushim nga puna të administratorëve;
- d) zgjedhje dhe pushim nga puna të revizorëve dhe likuidatorëve të pavarur;
- e) përcaktimin e shpërblimit të personave të cituar në pikat "c" e "d";
- f) monitorim dhe supervizionim të zbatimit të politikave të shoqërisë nga ana e administratorëve duke përfshirë edhe bilancin e ushtrimit dhe raportin e performancës;
- g) përshtatje të bilancit ushtrimor dhe raportit të performancës;
- h) shpërndarje të fitimeve vjetore;
- i) rritje dhe zvogëlim i kapitalit të Shoqërisë;

- j) nën ndarje të aksioneve në pjesë dhe tërheqje të aksioneve;
- k) përfaqësim të Shoqërisë në çështje gjyqësore dhe në çështje të tjera gjyqësore kundër administratorëve;
- l) riorganizim dhe zgjidhje të Shoqërisë;
- m) hartim i rregullores së brendshme;
- n) çështje të tjera të parashikuara nga Ligji ose nga Statuti.

Një ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër i autorizuar, në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve, ose nga një i autorizuar i tretë.

Administratori i Shoqërisë nuk mund të përfaqësojë një ortak në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve.

Autorizimi lëshohet vetëm për një Asamble të Përgjithshme të Ortakëve, duke përfshirë edhe mbledhjen e rikonvencionuar.

#### Neni 9

##### Metoda e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret me anë të letrës rekomande me kthim përgjigje ose më postë elektronike (e-mail). Letra ose e-mail përmban vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe u dorëzohet, të gjithë anëtarëve, sëbashku me rendin e ditës, brënda dhe më vonë se 7 ditë përpara datës së mbledhjes.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas dhe në përputhje me nenin 1, atëherë, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendim, vetëm nëse të gjithë ortakët e Shoqërisë bien dakort me vendimmarrjen, pavarësisht parregullësisë.

#### Neni 10

##### Quorum

Në rastet kur kërkohet shumica e anëtarëve të zakonshëm, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë Ortakët të cilët përbëjnë më shumë se 40% të aksioneve me të drejtë vote. Në rastet kur kërkohet shumica e anëtarëve të kualifikuar, në bazë të Nenit 87, të Ligjit "Mbi Sipërmarrësit dhe Shoqëritë Tregtare" Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë Ortakët të cilët përbëjnë gjysmën e votave, kur marrin pjesë në votim personalisht, me anë të letrës rekomande ose me anë të postës elektronike (e-mail) sipas nenit 88, pika 3, të këtij Ligji. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk arrin quorumin e vendosur në nenin 1, takimi do të rimblidhet me të njëjtin rend dite, brënda 30 ditëve.

#### Neni 11

##### Mënyra e vendimmarrjes

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos me maxhorancë tre të pestat e votave të Ortakëve që marrin pjesë në votim për ndryshimin e Statutit, rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar, shpërndarjen e fitimit, riorganizimin dhe zgjidhjen e Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos me maxhorancë e votave të pjesëmarrësve për çështje të tjera si: Përcaktim i politikave të shoqërisë; zgjedhje dhe pushim nga puna të administratorëve; zgjedhje dhe pushim nga puna të revizorëve dhe likuidatorëve të pavarur;

përcaktimin e shpërblimit; monitorim dhe supervizionim të zbatimit të politikave të shoqërisë nga ana e administratorëve duke përfshirë edhe bilancin e ushtrimit dhe raportin e performancës;

përfaqësim të Shoqërisë në çështje gjyqësore dhe në çështje të tjera gjyqësore kundër administratorëve; hartim i normave dhe procedurave për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;

Çdo ndryshim i Statutit duhet të paraqitet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet e bëra në regjistrin e Shoqërisë

#### Neni 12

##### Përfshirja nga drejta e votës

- 1) Një ortak nuk mund të votojë nëse Asambleja e Përgjithshme vendos që:
  - a) vlerësojë performancën e tij;
  - b) nuk respekton detyrimet;
  - c) çdo ankesë kundër tij në emër të Shoqërisë;
  - d) për dhënien ose jo të një përfitim të ri.
- 2) Kur një ortak përfaqësohet nga një person me prokurë, ky person konsiderohet në të njëjtin pozicion për sa i përket konflikteve të interesit të anëtarit që përfaqëson.

#### Neni 13

### **Administrimi**

Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë për një kohëzgjatje të vendosur nga Statuti jo me shumë se 5 vjet, me mundësi rrizgjedhje. Emërimi ka efekt ligjor sapo kryhet regjistrimi pranë QKR (Qendra Kombëtare e Regjistrimit). Administratorët e një Shoqërie mëmë sipas nenit 207 të këtij Ligji nuk mund të zgjidhen Administratorë të një kompanie bijë dhe anasjelltas. Çdo zgjedhje në kundërshtim me këtë udhëzim, konsiderohet zero. Emërimi i Parë i Asamblesë së Përgjithshme të parë, emëron Administrator të Shoqërisë: PELLICANI Massimo, Bari (Itali), Strada San Nicola n. 39/D per nje periudhe 5 vjecare.

### **Neni 14**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrim të:

- a) Menaxhojnë aktivitetin e Shoqërisë duke zbatuar politikat e përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- b) Përfaqësojnë Shoqërinë;
- c) Sigurohen që librat kontabël dhe dokumentat e nevojshme të jenë ruajtur;
- d) Japë dhe firmosë bilancin ushtrimor dhe bilancin e konsoliduar dhe raportin e performancës dhe ti prezantoje Asamblesë së Përgjithshme për miratim sebashku me propozimin për shpërndarjen e fitimit;
- e) Krijojë një sistem alarmi të shpejtë përsa i përket zhvillimeve që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- f) Arkivojë regjistrimet dhe të paraqesë të dhënat e duhura të shoqërisë sipas Ligjit mbi Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) Vërë në dijeni Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve mbi zbatimin e politikave të shoqërisë dhe realizimin e veprimeve të rëndësishme të veçantë për performancën e Shoqërisë;
- h) Të ndjekë detyrat e tjera të vendosura nga Ligji ose nga Statuti.

Administratorët janë të detyruar të raportojnë pranë Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor ose bilanci ndërmjetës, rezulton se egziston reziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme për gjashtë muajt e ardhshëm;
- Shoqëria do të shesë ose në të kundërt disponon disa aktive që arrijnë më shumë se 5% të kapitalit të shoqërisë me rrjedhojë bilancin e fundit të certifikuar;
- Kompania, brënda 2 viteve të para të regjistrimit, propozon blerjen e të mirave që i përkasin një Ortaku dhe që përfaqëson 5% të kapitalit të shoqërisë me pasqyrim në bilancin e fundit të certifikuar;

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, menaxhon kompaninë sëbashku. Asambleja e Përgjithshme mund të refuzojë Administratorin në çdo moment me maxhorancë të zakonshme.

Çdo pretendim lidhur me shpërblimin e administratorit, që rrjedh nga marrëdhënia kontraktuale rregullohet nga dispozitat aktuale.

### **Neni 15**

#### **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës ndaj kompanisë apo palëve të treta për dëmet e shkaktuara nga shkelja e ligjit dhe e Statutit ose për gabimet e bëra gjatë administrimit të kompanisë. Pasojat për çdo marrëveshje jo të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, që i shkakton dëme kompanisë, do të ngarkohet Administratorit dhe Ortakut që ka marrë vendim individualisht ose së bashku, si dhe pasojat respektive.

Përveç asaj që është parashikuar në dispozitat e përgjithshme lidhur me besueshmërinë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit "Për sipërmarrësit dhe Shoqëritë Tregtare", administratori është i detyruar të:

1. a) të kryejë detyrat e veta ashtu siç parashikohet me ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke përfshirë edhe mbrojtjen mjedisore të aktivitetit të saj;
- b) ushtron fuqitë e tij sipas ligjit dhe statutit për qëllimet e përcaktuara;
- c) jep opionionin e tij për vendimet e çështjeve të ndryshme;

- d) shmang konfliktet aktuale dhe të mundshme midis interesave personale dhe atyre të shoqërisë;  
e) kryen detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdes.
2. Administratori, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, është përgjegjës për çdo veprim ose mosveprim të kryer në mënyrë vetëdijshme në dëm të shoqërisë, përveç nëse veprimi apo mosveprimi është kryer jo në mirëbesim, duke u bazuar në një hetimi të arsyeshëm dhe informacionit racionalisht të lidhur me qëllimet e kompanisë.
  3. nëse Administratori vepron në kundërshtim me funksionet e tij dhe shkel standardet profesionale të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, ai konsiderohet përgjegjës dhe duhet të dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara nga shkelja, si dhe për ndërpresin çdo fitim i realizuar nga ai, ose nga dikush i lidhur me të, në kundërshtim me funksionet e shoqërisë. Administratori duhet të provojë përputhshmërinë me detyrimet dhe standardet. Në rast se shkelja kryhet nga më shumë se një administrator, atëherë ata janë bashkërisht përgjegjës ndaj kompanisë.
  4. Në veçanti, Administratori i kërkohet të dëmshpërblejë Shoqërinë, për dëmet e shkaktuara, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare", nëse ai kryen veprimet e mëposhtme në shkelje të këtij ligji:
    - a. Rikthen ortakëve kontributet;
    - b. Pague interesave ose dividende Ortakëve;
    - c. Shpërndan të mirat e shoqërisë;
    - d. Lejon shoqërinë të vazhdojë kryerjen e aktivitetit kur kjo gjëndet në një situatë financiare të tillë që nuk mund të jetë në gjëndje të paguajë detyrimet e saj;
    - e. Jep hua palëve të treta.

Përveç kërkesës për dëmshpërblim që i atribuohen personalisht administratorit, Ortakët, individualisht ose bashkërisht, gëzojnë të drejtën e paraqitjes së padisë penale kundër administratorit.

Ankuesit gëzojnë të drejtën për të ndjekur të gjitha mjetet ligjore për rimbursim të plotë të dëmit të shkaktuar ndaj kompanisë, duke përfshirë kompensimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i Asamblesë nuk mund të ndalojë paraqitjen e një ankese kundër Administratorit për gabimet e bëra gjatë punës së tij..

#### **KAPITULLI IV VITI FISKAL - EKSPERTI**

##### **Neni 16 Viti fiskal**

Ushtrimi fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Bën përjashtim viti i parë ushtrimor i cili fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë QKR dhe mbyllet më 31 dhjetor 2017.

##### **Neni 17 Eksperti**

Eksperti duhet të kontrollojë tërë dokumentacionin kontabël të aktivitetit ekonomik të shoqërisë tregtare, kontrollin vjetor dhe periodik të ndjekur nga ky në rastin kur është emëruar dhe kryen të tilla detyra për llogari të shoqërisë.

Në fund të kontrollit, verifikon, certifikon dhe përgatit, një raport me shkrim, për publikimin e rezultateve të bilancit vjetor si dhe të raportit mbi kontrollin peiodike që duhet të paraqesë në kohë të vendimit për miratim nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

#### **KAPITULLI V ZGJIDHJA - RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

##### **Neni 18 Zgjidhja dhe likuidimi**

Shoqëria mund të zgjidhet në çdo moment, në rastet e mëposhtme:

- në përfundim të periudhës së vendosur nga Statuti;
- Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
  - Hapje të procedurës së falimentimit;

- Nëse nuk ka kryer aktivitet tregtar për një periudhe dy vjecare dhe nuk ka njoftuar gjëndjen e saj pasive sipas pikës 23 të nenit 43 të Ligjit Nr. 9723 në «Qendra Kombëtare e Regjistrimit»;
- Me vendim gjykatë

Në këtë rast anëtarët marrin vendimin me shkrim, në të cilën ofrojnë metodën e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një ose më shumë likuidatorë dhe të gjitha dokumentet e lëshuara nga kompania duhet të ketë emrin e likuidatorëve dhe emërimin shtesë "Kompania në likuidim"

Shpërbërja e një shoqërie tregtare, ka si pasojë fillimin e procedurave të likuidimit, vetëm nëse ajo nuk ka nisur procedurat e falimentimit.

Likuidimi kryhet nga likuidatorët për llogari të Ortakëve.

Nëse Ortakët nuk vendosin brenda 30 ditëve nga shpërbërja, emërimin e likuidatorëve, çdo person i interesuar mund të paraqesë pranë gjykatës kërkesën për emërim të një likuidatori.

#### Neni 19

#### Riorganizim i shoqërisë- Shkrirja – Ndarja

Shoqëria mund të ndahet, shkrihet në bazë të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve sipas dispozitave të parashikuara në pjesën e IX të Ligjit Nr. 9901, dt 14.04.2012 "Për sipërmarrësit dhe Shoqëritë Tregtare"

#### Neni 20

#### Shënim Ligjor

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e saj në përputhje me këtë Statut dhe me Legjislacionin Shqiptar. Përveç se në rastet kur parashikohet ndryshe nga ky Statut, aplikohen dispozitat e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodi Civil dhe çdo ligj tjetër specifik i Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 21

#### Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që dalin nga ose në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e këtij Statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje ndërmjet shoqërisë dhe palëve të treta do ti drejtohen Gjykatës Shqiptare.

#### Ortakët

#### Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (Limited Liability Company) BRAINACTIONE

*Pellicani Vito (per HUHET Sh.p.k)*

VITO PELLICANI

*Vito Pellicani*

*Pellicani Massimo*

MASSIMO PELLICANI

*D'Alessio Maria*

D'ALESSIO MARIA

*Carnimeo Zeno*

CARNIMEO ZENO

DATA  
09/06/2017

*Përkthues  
gjuhës shqipe  
[Signature]*